

## Informacion Mujor – Dhjetor 2021

Emri i Fondit	Fondi i Pensioneve Vullnetare "SIGAL"
Struktura Ligjore	Fond Pensioni*
	Licensuar nga AMF me licensë nr. 2, datë 30.03.2011
Administrimi i Fondit	Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a.
Themeluar	Janar 2006
Monedha	Lekë
Banka Depozitare	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.
Auditues	Grant Thornton Sh.p.k.

\*Rregulluar nga Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"

Komision në Hyrje	0%
Komision në Dalje	0%
Komision Vjetor Administrimi	2.20%
Penalitet për tërheqje të parakohshme	Sipas Rregullores së AMF
Komision Performance	0%
Shuma fillestare e kuotës	1.000 Lekë
Kontributi fillestar minimal	1.000 Lekë
Kontributi minimal pasues	1.000 Lekë

### Objektivat dhe Politika e Investimit

#### Objektivat e Investimit

Fondi i Pensioneve ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

#### Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

### Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Dhjetor 2021

Vlera Neto e Aseteve	2,043,929,383.33 Lekë
Numri i anëtarëve	9079
Çmimi i Kuotës	1,546.4480 Lekë
*Fitimi vjetor (31/12/20-31/12/21)	3.67%
**Kohëzgjatja	4.21

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi  
\*\*Kohëzgjatja në datën e raportimit 31.12.2021

### Portofoli i Investimeve në datën 31 Dhjetor 2021




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.

**Për Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL" treguesi është në nivelin 1, ose niveli më i ulët i rrezikut.**

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portofoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Treguesi është i bazuar në të dhënat historike të 5 viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

## Performanca e Fondit

Performanca e Fondit deri në 31.12.2021

Gjatë muajit Dhjetor 2021 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për këtë muaj ka rezultuar 0.261%.

Fitimi vjetor neto (%) për 12 muajt e fundit (Periudha: 31 Dhjetor 2020 – 31 Dhjetor 2021) ka shënuar nivelin 3.67%. Fitimi i 3 mujorit të katërt të 2021 ka rezultuar në nivelin 0.81%.

Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.


### Performanca vjetore (%)

	2017	2018	2019	2020	2021
Fondi	4.55	4.30	4.17	3.53	3.67


### Rritja e Vlerës Neto të Aseteve (%)

	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Fondi	22.20	19.45	28.37


### Fitim vjetor neto (%)



### Ecuria e Çmimit të Kuotës



## Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një trend rënës gjatë muajit Dhjetor. Raporti i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.28 në rënie nga 1.78 raport mbulimi gjatë muajit Nëntor 2021.

Rendimenti i Bonove 12-mujore të Thesarit gjatë muajit Dhjetor arriti nivelin 1.57% nga 1.71%, me një rënie prej 0.15%. Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 2.00% nga 2.10% me një rënie prej 0.10%.

Për obligacionin 3 vjeçar rendimenti ka shënuar nivelin 2.542% nga 2.577% me një rënie prej 0.035% krahasuar me ankandin paraardhës. Për obligacionin 7 vjeçar rendimenti arriti nivelin 4.00% nga 4.01% me rënie prej 0.01%.

Për obligacionet e maturiteteve 5, 10 dhe 15 vjeçar nuk janë zhvilluar ankande gjatë këtij muaji, ndërkohë në ankandet paraardhëse, këto tituj kanë rezultuar me rendiment përkatësisht në nivelet 3.467%, 5.20% dhe 5.88%.

## Informacion Praktik

### Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 88, 89 dhe 90 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

### Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL". Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondit të Pensionit Vullnetar "SIGAL" dhe në <https://fondisigal.com.al/>

### Kontakt:

Rr. "Donika Kastrioti", Tiranë

Email: [info@fondisigal.com.al](mailto:info@fondisigal.com.al)

Phone: +355 (0) 44 511 666